

VENDIM
Nr. 193, datë 5.4.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 501, DATË 25.8.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË PËRKOHSHME
SHTETASVE AFGANË DHE PERSONAVE PA SHTETËSI, ME VENDQËNDRIM
TË PËRKOHSHËM OSE TË PËRHERSHËM NË REPUBLIKËN ISLAMIKE TË
AFGANISTANIT, DHE PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E
FLUKSIT TË KËRKUESVE TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2/1, togfjalëshi “... dhe me 6 (gjashtë) muaj të tjerë ...”, zëvendësohet me “... deri më 24.8.2023 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama